

## LEKSIKU I SHQIPES NË DY FJALORË

J. G. VON HAHN (1854) – K. KRISTOFORIDHI (1904)

Xhevat LLOSHI

Tiranë

Punim studimor

Naim Frashëri kishte qenë një nga nënshkruesit e letrës së kryesisë të Shoqërisë së Stambollit për Bukureshtin më 23 korrik 1882, në të cilën kërkohet të shtypej Fjalori i gjuhës shqipe i K. Kristoforidhit, sepse ishte një punë “që e pritnimë me gojë hapëtë” dhe në lutjen e tyre që ajo të mos vonohej ishte edhe lutja e “tërë kombit edhe e djemet për gjithë jetën e jetësë.”

Mirëpo më 5 shtator 1896, në një letër dërguar përsëri Bukureshtit për Vasil Tërpon, Naimi ka shkruar: “Mos epni të holla për fjalëtoret të Kristoforidhit, se nuk është e vërtetë, e pamë ne, ka marrë ca fjalë këtu-këtu nga një radhua që ka bërë Hahni, po s’i ka as me radhë, as të shumta. Ne e kemi zën’ edhe Fjalëtoren’ e po e bëjmë, s’duam as pag’ as gjë, po si të mbarohenë ato që keni aty, vjen edhe ajo, se çdo mizë s’bën mjaltë.” Shpjegimi i kësaj kthese tërësisht zhvlerësuese kundrejt lavdërimeve të mëdha të vitit 1882 mund të kërkohet te zhvillimet e reja, domethënë te puna e Naimit dhe e Samiut për të bërë një fjalor të ri. Nuk u botua prej tyre ndonjë fjalor, por ky është fakti domethënës, se Kristoforidhi dhe Naimi u përkisnin dy brezave, sepse kur i pari e kishte mbyllur rrugën e tij, i dyti kishte shpalosur një krijimtari të begatë. Mbetej edhe një faktor teknik: Kristoforidhi nuk e kishte përgatitur dorëshkrimin për shtyp; nevojiteshin të paktën edhe dy vjet për ta përfunduar; shkurt, ishte i papërfunduar. Ndërkaq, nuk mund të mos e vë në dukje, se vetë Naimi tashmë ishte i sëmurë

rëndë, thuhet se nuk ishte as në gjendje të shkruante. Ma merr mendja, se ai kështu po mbronte punën e të vëllait dhe njëkohësisht prapa këtyre rreshtave fshihet dëshpërimi për mosarritjen e botimit të një fjalori tjetër.

Megjithatë, e quaj të domosdoshme të shqyrtohet objektivisht çështja e theksuar nga Naimi, se Kristoforidhi kishte marrë aty-këtu ca fjalë nga Fjalori i J. G. fon Hanit më 1854. Ky pohim i Naimit është krejt i pavërtetë. Nëse thjesht krahasohet numri i përgjithshëm, te Kristoforidhi kemi 11675 fjalë, pothuaj dy herë më shumë njësi leksikore se te J. G. fon Hani 6210, dhe nga ana tjetër, është krejt e natyrshme, që kur leksiku është i vogël, te autorë të ndryshëm do të ndeshen njësoj pjesa më e madhe e fjalëve. Kam vënë në dukje, që ato pak fjalë, të cilat i kishte regjistruar Arnold fon Harfi në shek. XV, përputhen gjerësisht me ato pak fjalë që ka regjistruar Evlija Çelebiu në shek. XVII, ndonëse ishin dy shekuj të ndryshëm dhe dy autorë tërësisht të ndryshëm. Afërsisht 4500 fjalë të leksikut të Hanit janë edhe te Kristoforidhi.

Dallimet e këtyre dy fjalorëve të rëndësishëm në ecurinë e leksikografisë shqipe nuk janë thjesht te numri i përgjithshëm. Shqyrtimi i leksikut zbulon karakteristika krejt të tjera.

Do të paraqes në fillim për krahasim vetëm një shtresë leksikore: huazimet e shqipes nga turqishtja. Kjo nuk është një zgjedhje e rastësishme. Kur ishte konsull në Janinë, më 1847-1850, J. G. fon Hani e pa se nuk mund t'i arrinte synimet e veta në atë qytet, i cili para jo shumë vjetësh kishte qenë kryeqyteti i sundimitarit të pushtetshëm, Ali Pashë Tepelenës, pa njohur shqipen, gjuhën e shumicës së banorëve dhe sidomos të tregtarëve. Dihet se ai mori si mësues të shqipes Kristoforidhin dhe Anastas Panajotin. Këtë e ka përmendur në veprën e tij *Studime shqiptare*. Aty ka vënë në dukje edhe diçka të veçantë: “gega lexonte e shkruante diçka turqisht (një punë kjo e vështirë).”<sup>1</sup> Nënkuptohej, që vetë Hani nuk e dinte turqishten, ndërsa Kristoforidhi dinte diçka dhe vështirësia niste që nga alfabeti i osmanishtes së shkruar me shkronja arabe. Më 1883 ai e ka përmendur turqishten në gjashtë gjuhët e huaja që zotëronte.

Vetë Hani nuk e ka quajtur punimin e tij drejtpërdrejt fjalor, por *Kontribute për një leksikon shqip-gjermanisht*, sepse e shihte si pjesë të punimit të vet. Rrjedhimisht, nuk është e drejtë të flitet për mangësitë e tij. Ndër ato 6210 njësi leksikore, kam numëruar 720 huazime të shqipes nga turqishtja. Prej tyre autori ka shënuar me shkurtimin T, se janë turqizma vetëm 274 fjalë, të tjerat nuk i ka cilësuar kështu me shënim. Përveç Dhiatës së re të vitit 1827, nga burimet e shkruara Hani ka marrë lëndë sidomos prej fjalorit i W. Martin-Leake-ut, botuar më 1814.<sup>2</sup> Te ky fjalor ka

1870 njësi. Prej tyre kam gjetur si turqizma, bashkë me fjalët e prejardhura, 266 njësi. Ky është i pari hulumtues i shqipes, i cili i ka shënuar me një T turqizmat e shqipes, siç do të bënin Hani dhe autorë të tjerë më pas. Por si të tilla ai ka shënuar vetëm 161 fjalë. Gjithsej prej tij Hani ka marrë 152 turqizma, por gjysmat nuk ishin të shënuara si turqizma te Martin-Liku, domethënë si të tilla janë shtuar prej Hanit. Madje nuk ka marrë as 38 fjalë, që Martin-Liku i kishte shënuar si turqizma. Përpjesëtimi është ky: te Martin-Liku turqizmat zënë rreth 9% të fjalësit, një tablo afër së vërtetës për kohën.<sup>3</sup> Te Hani ndeshen 720 turqizma bashkë me fjalët e prejardhura; përqindja është afër 11,5%, më e madhe kundrejt asaj tufe fjalësh.

Ta shohim tashti si është te Kristoforidhi. Ndër 11650 njësi ai ka 155 turqizma, por i ka njohur si të tilla vetëm 12; kjo ka ndodhur ose sepse nuk ka qenë në gjendje që t'i përcaktonte si të tilla, ose sepse ka gabuar për prejardhjen e tyre. Kështu ai kujtonte se *ahur, boll, dimite, fener, frangjyzë, karafil, liman, mandall, mangall* ishin nga greqishtja dhe disa të tjera nga sllavishtja. Aleksandër Xhuvani, pas një pune të gjatë e ktheu Fjalorin e Kristoforidhit në alfabetin e sotëm dhe i bëri një varg ndryshimesh. Duke u nisur nga shënimet e autorit për vetëm 12 njësi turqizma, Xhuvani ka shkruar në Parathanie: “gjinden pak fjalë turqishte e greqishte ndër ato fjalë të Fjalorit, jo ma tepër se 20, të cilat ose i kanë shpëtue Kristoforidhit, ose e ka mendue se duheshin si më të përdorshme e të nevojshme.”<sup>4</sup> Ky pohim është i gabuar në shkallë të pabesueshme. Fjalori i Kristoforidhit ka 155 turqizma, bashkë me fjalët e prejardhura. Prej tyre 85 ishin edhe te Hani. Përpjesëtimi del 1,35% kundrejt gjithë fjalësit, domethënë afër dhjetë herë më pak se te Hani. Por po të lihen mënjanë shifrat, habia shfaqet edhe më e madhe. Nuk mund të quhet e pranueshme, që Kristoforidhi nuk i dinte fjalë, si: *aga, bajrak, bilbil, çadër, daulle, fukara, hajdut* etj., që janë të gjitha te Hahni. Fjalën “kurban” madje ai e ka përdorur në përkthimet biblike, por te Fjalori nuk e ka. As nuk mund të përfytyrohet, që elbasanasi Konstandin nuk e dinte fjalën “raki”, kur ai pinte aq shumë vitet e fundit, sa u sëmur. Si shpjegohet kjo çudi e madhe?

Shpjegimi gjendet te dy dorëshkrime të viteve 1883-1884, që janë në Arkivin Qendror të Shtetit. I kam zbërthyer hollësisht ato në dy punime,<sup>5</sup> prandaj këtu po jap shkurt vetëm përfundimet. Titulli i dorëshkrimeve është “Pjesa etimologjike e gjuhës shqipe. Fjalët turke që përdoren në shqipen”. Janë gjithsej 730+20 njësi, bashkë me fjalët e prejardhura, të cilat autori i mendonte si turqizma (por jo gjithnjë i ka përcaktuar drejt; në të gjitha rastet gjatë këtij shkrimi nuk jam marrë me gabimet e të dy autorëve). Ashtu si te Fjalori, ka dhënë variantet e ndryshme, krahinën së cilës i për-

kasin, sidomos duke dalluar dy dialektet kryesore. Dorëshkrimet nuk kanë nga Hani 175 turqizma, madje dhjetë prej tyre Hani i kishte shënuar si turqizma, kurse 47, përsëri jo nga Hani, i ka përfshirë Kristoforidhi edhe në lëndën e fjalorit, pa e rrokur se ishin turqizma.

Përfundimi i parë është ky: Kristoforidhi ka përfshirë shumë pak turqizma në fjalorin e tij, pjesën më të madhe të kësaj pakice sepse nuk i ka shquar si të tillë, por kjo ka ndodhur jo sepse nuk e dinte që atë shtresë nuk e kishte në përdorim shqipja. Përkundrazi, ai nga 720 turqizmat e Hanit ka paraqitur në dorëshkrimet 530, natyrisht, pa përjashtuar as rakinë, sepse e njihte që ishin *Fjalë turke që përdoren në shqipen*. Duke shtuar lëndë tjetër, ai ka arritur te dorëshkrimet një shifër fare të afërt me atë të Hanit. Të gjitha këto fjalë në mënyrë të vetëdijshme ai i ka hequr nga leksiku i fjalorit.

Por fakti më i rëndësishëm është se në dorëshkrimet Kristoforidhi ka 400 turqizma, për të cilët ka vënë pranë një sinonim të shqipes. Për të dalë e qartë se çfarë peshe ka ky fakt, kam bërë një krahasim me *Fjalorin sinonimik* të vitit 2004.<sup>6</sup> Ka një varg fjalësh, të cilat për arsye jo shkencore Fjalori sinonimik nuk i ka përfshirë, për shembull: *bardhakçi, bereqavers, bylyk, çezme, çifutëri, fëstëk, harbi, kallaballëk, nishanoj, sfungjer, shamatoj, tahma, tahmaqar* nuk i ka. Kurse për të gjitha këto Kristoforidhi ka dhënë përgjegjëse të shqipes: *shtambar, faleminderës, turmë, krua, jude-ntjë, koçimare, shufër (purtekë), gjindje, shenoj, shpuzë, bëj zallahi, lakmim, lakmimtar*. Domethënë një Fjalor sinonimesh i shekullit XXI nuk ka sinonime, që i kishte paraqitur Kristoforidhi një shekull e gjysmë më përpara. Nuk do të hyj më gjerë në këtë çështje, por po shtoj se për “bojë” Fjalori sinonimik ka vetëm “trup”, domethënë duhet shkruar te kjo fjalë, por te kjo është edhe “shtat”. Ndërsa te “shtat” janë vënë “trup, japi”. E përse te “bojë” nuk është vënë “shtat”, kur e ka me të drejtë Kristoforidhi? Është e njohur thënia “Ç’ha goja, e tregon boja”.

Sinonimet Kristoforidhi nuk i ka vënë për të dëshmuar pasurinë e leksikut të shqipes, por i ka dhënë për të treguar se me cilat fjalë të shqipes mund të zëvendësohen këta turqizma. Atëherë përfundimi i përgjithshëm është, se Kristoforidhi e mendonte si purist shqipen e shkruar, e lëvruar, domethënë pa fjalë të huaja, si shqipe të pastër, sepse kështu dëshmohej lashtësia e saj dhe kryhej roli kombëtar i saj. Mënjanimi i fjalëve me prejardhje të huaj nuk do ta varfëronte shqipen e lëvruar, në rast se do të ishin barasvlerëset shqipe. Do të pranohet madje, se disa prej atyre sinonimeve mbeten edhe sot me vlerë për pasurimin e pastërtinë e shqipes.

Duke u nisur nga kjo paraqitje, mund të kuptohet një rast tjetër gjithashtu pak i çuditshëm. Në fund të Fjalorit të botuar më 1904 ka një

shtojcë me titullin greqisht “Përmbledhje e fjalëve sllave që përdoren nga shqiptarët e sotëm, të cilat kanë hyrë në Shqipëri gjatë sundimit sllav”. Përse është kjo shtojcë, e cila nuk e ka vendin aty? Dorëshkrimi i Fjalorit i ra në trashëgimi djalit tjetër të Kristoforidhit, Stefanit. Ai gaboi kur ia dorëzoi konsullit grek në Durrës, i cili e përcolli në Athinë te Ministria e jashtme.<sup>7</sup> Duke mos e njohur punën e të atit, Stefani bëri edhe një gabim tjetër: bashkë me dorëshkrimin e Fjalorit dorëzoi edhe këtë dorëshkrim, i cili bënte pjesë në një tjetër grup të punimeve të autorit. Edhe ata që e botuan Fjalorin në Athinë nuk e kishin kuptuar këtë gjë, prandaj e shtypën në fund të tij. Në 18 faqe të shtypura janë 365 njësi. Kristoforidhi është orvatur të gjejë prejardhjen e tyre nga gjuhët sllave, porse në tërësi ka dështuar keq. Prej tyre në trupin e Fjalorit janë përfshirë shumica e njësive (mbi 300), por edhe ato me ndryshime e plotësime të ndjeshme dhe tashmë pa etimologjitë. Nënkuptohej, që autori e ka ndier vetë, që nuk kishte bërë punë të mirë me njësitë e dorëshkrimit. Prej tyre nuk janë përfshirë 62 njësi. Është e qartë se këtë listë të sllavizmave e kishte përgatitur mjaft kohë përpara sesa ta sistemonte lëndën e fjalorit dhe e ka parë vetë se kishte gabuar në shumicën e rasteve, prandaj prej fjalëve në fund të fjalorit ka përfshirë shumicën e lëndës në Fjalor dhe e ka lënë mënjanë dorëshkrimin. As A. Xhuvani nuk e ka ribotuar shtojcën më 1961 siç ishte në librin e shtypur. Është njësoj domethënëse se edhe këtë listë sllavizmash Kristoforidhi e ka nxjerrë nga leksiku i Hanit, ashtu si edhe për turqizmat; shumica e tyre janë marrë nga Hahni, me fare pak përjashtime.

Megjithatë edhe kjo pjesë, sado me gabime të mëdha etimologjike,<sup>9</sup> mbetet me vlerë, sepse duke u nisur nga parimi, që leksiku i shqipes së lëvruar duhej të përmbante sa më pak huazime, Kristoforidhi edhe këtu ka vënë rreth 100 sinonime, domethënë në 30% të rasteve. Kaq ka arritur të bënte. Nga krahasimi me lëndën e Fjalorit, del se në shumicën e tyre këto sinonime nuk janë përfshirë, kështu që nuk e humbasin vlerën

Edhe kjo listë e botuar sllavizmash bashkë me dorëshkrimin për turqizmat<sup>10</sup> bën pjesë në tufën e dorëshkrimeve për huazimet e shqipes, domethënë të përpjekjeve të Kristoforidhit për të hetuar fjalët e huaja në leksikun e shqipes, të cilat ndonëse ishin në përdorim, si purist ai nuk do të parapëlqente që të bëheshin pjesë e leksikut të përgjithshëm të shqipes së shkruar, ose po të shpreheshin më saktë, një pjesë e tyre. Kanë mbetur dorëshkrim, për shembull, një listë me 88 fjalë të ardhura prej italishtes, lista me fjalë nga latinishtja e greqishtja, madje edhe me rrënjë nga sanskritishtja. Kuptohet, që atij i pëlqente të njihej si etimolog i shqipes, por nuk e kishte përgatitjen për këtë. Më me rëndësi për të ishte të gjente

prejardhjen e njësisive të leksikut, sidomos nga turqishtja, që të mënjano-heshin nga ngulitja në shqipen e lëvruar. Praktikisht këtë e ka bërë në shkri-met dhe përkthimet e veta. Shembulli më i qartë është rasti i botimit të përk-thimit të parë, *Katër ungjijtë dhe Punët e Apostojve* më 1866. Si redaktor ka qenë N. Serreqi, i cili kishte shtuar mjaft turqizma nga e folmja e Shko-drës. Por, në botimin e vitit 1869, kur nuk ishte më redaktor Serreqi, Kristoforidhi i ka hequr sistematikisht turqizmat. Nuk është nevoja të citoj këtu rastet, kur ai e ka shprehur qartë qëndrimin kundrejt huazimeve.

Punimet e Kristoforidhit për fjalët e huazuara përfshihen në rrymën e gjerë të veprimtarisë së rilindësve në këtë lëmë (pavarësisht prej gabimeve të tyre të shpeshta) dhe në qëllimet e tyre atdhetare, ndërsa vetëm anësisht me disiplinën shkencore të etimologjisë.

Përbërja e leksikut në veprat e këtyre dy leksikografëve shumë të rëndësishëm në historinë e gjuhës shqipe ka dallim të ndjeshëm jo nga sasia. As nuk qëndron pohimi, se Kristoforidhi ka zgjedhur prej të parit ca fjalë aty-këtu. Fjalori i J. G. von Hahn-it është një paraqitje e leksikut të shqipes siç ishte në përdorim në gjuhën e folur e të shkruar, me aq sa e quajti të nevojshme autori për punimin e tij të gjerë. Fjalori i K. Kristo-foridhit është një paraqitje e leksikut të shqipes ashtu si do të duhej të ishte në një gjuhë shqipe të shkruar, të lëvruar. Me fjalë të tjera, leksiku i Hanit është ai që ishte; leksiku i Kristoforidhit është ai që duhej të ishte në të ardhmen. Hani përpiquej të ishte një studiues objektiv; Kristoforidhi ishte një planifikues gjuhësor, i bindur se kishte të drejtë të ndërhynte në ecurinë e mëtejshme të shqipes, deri te vetëlavdërimi se do të mbetej babai i shqipes.

Nuk mund ta mbyll pa e përfshirë në karakterizim edhe Naimin. Kam bërë një krahasim të gjithë leksikut te poema “Bagëti e bujqësia” të Naimit me fjalësin e Kristoforidhit. Te Naimi ka 868 njësi dhe mbi 90 për qind e tyre gjenden te Fjalori i Kristoforidhit, domethënë poema e Naimit mund të lexohet lehtësisht me Fjalorin e Kristoforidhit.<sup>11</sup> Ndihej në hedhjen e themeleve të një gjuhe letrare dëshmohej si e përbashkët për të dy këta lëvruar të shquar të shqipe. Njëri ishte nga Elbasani e tjetri nga Frashëri, u përkisnin dy dialekteve të ndryshme, por i përkisnin të njëjtit orientim kulturor e kombëtar, që do të përcaktonte po atë frymë gjuhësore. Rivaliteti i pjesëmarrësve edhe në një lëvizje të përbashkët është dukuri e natyrshme. Me syrin e sotëm shihet se Naimi e vuri në provë shqipen për të përmbushur kërkesat artistike të letërsisë shqipe; Kristoforidhi iu përkushtua vetë shqipes si gjuhëtar dhe si mbrujtës i shqipes së shkruar.

## Shënimet

Hahn, Johann Georg von: *Albanesische Studien*, 1. Heft III, 1854, f. V.

Martin-Leake, William: *Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe*. Bota Shqiptare, Tiranë, 2006.

Shih më hollësisht: Lloshi, Xhevat, *Fjalorët e shqipes me turqishten*. ALSAR, Tiranë, 2020. f. 58-59.

Xhuvani, Aleksandër: *Parathanie* në “Fjalor shqip-greqisht prej Konstandin Kristoforidhit”. Çekoslovakia, 1961, f. 8.

Lloshi, Xhevat: *Dorëshkrimet e K. Kristoforidhit për huazimet e shqipes nga turqishtja*, në: “Perla”, 2014, nr. 1, f. 115-136; si dhe *vep. e cit.*, f. 105-114.

*Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.

Ja edhe pak shembuj të tjerë, për të dëshmuar se një Fjalor i vitit 2004 nuk ka arritur as nivelin e Kristoforidhit një shekull e gjysmë më parë. Te “at” është vënë si sinonim “kalë”. Në të vërtetë ati është kalë shale dhe jo kalë që shërben për ngarkesë, siç ka dalë aty. Kristoforidhi ka vënë “hamshor”, që është kalë për ndërzim, kurse Fjalori 2004 këtë nuk e ka vënë te “kali”. Fjalori nuk e ka *dhelka* sinonime të *naze*; nuk e ka *veshnik* për *saçin*; *jude* për *çifut*, *gjëkafshë* për *hiç*; *fushaj* për *peshqir*; *shoqëri* për *ortakëri* (sot gjerësisht quhet *partneritet*) etj. Në këtë Fjalor ka edhe një absurditet, që trajtat pësore të foljeve paraqiten si fjalë më vete dhe paskan sinonimi të ndryshme. Edhe vetë titulli nuk është sipas natyrës së shqipes, sepse do të duhej *Fjalor i sinonimeve të gjuhës shqipe*. Në gjithë lëndën e fjalorit autorët kanë dëshmuar një njohje të dobët të shkencës së gjuhësisë, sepse gjithandej kanë ngatërruar llojet me gjininë. Kjo është si të thuash se “macja” dhe “tigri” janë sinonime, meqë bëjnë pjesë në gjininë e maceve. Një shembull i qartë i tillë është aty paraqitja e “ndërtesës” (gjinia) si sinonim me llojet: banesë, shtëpi, pallat.

Historinë e botimit të Fjalorit të K. Kristoforidhit e kam shtjelluar hollësisht në shkrimin *Fjalori i Kristoforidhit*, në revistën “Nëntori”, 1977, nr. 7, ribotuar edhe më 2005 te “Kristoforidhi përmes dokumentimit”, f. 111-140.

Shih edhe: Çabej, Eqrem: *Rreth disa etimologjive të Kristoforidhit*, në: “Bulletin për shkencat Shoqërore”, 1954, nr. 2, f. 31-49; nr. 3, f. 57-74.

Shih më hollësisht: LLOSHI, Xhevat, *Fjalorët e shqipes me turqishten*, ALSAR, Tiranë, 2020, f. 105-114.

Lloshi, Xhevat: *Naim Frashëri dhe Kristoforidhi*, në: Naim Frashëri dhe kultura shqiptare”, Tiranë, 2005, f. 175-180.

## **ALBANIAN VOCABULARY IN TWO DICTIONARIES J. G. VON HAHN (1854) - K. KRISTOFORIDHI (1904)**

### **Summary**

Naim Frashëri had been one of the signatories of the letter of the presidency of the Istanbul Society to Bucharest on July 23, 1882, in which it was requested for the Dictionary of the Albanian language by K. Kristoforidhi to be printed, because it was a work "that we waited for open-mouthed" and in their prayer that it should not be delayed was also the prayer of "the whole nation and the boys for the rest of their lives." However, on September 5, 1896, in a letter sent back to Bucharest to Vasil Tërpon, Naim wrote: "Do not spend money on Kristoforidhi's dictionaries, because it is not true, we saw it, he took some words here and there from a list made by Hahn, but he does not have them neither in order nor in big sums".

However, I consider it necessary to examine objectively the issue raised by Naim, that Kristoforidhi had taken here and there some words from the Dictionary of J. G. von Hahn in 1854. This statement of Naim is completely untrue. If we just compare the total number, in Kristoforidhi we have 11675 words, almost twice as many lexical units as in J. G. von Hahn 6210, and on the other hand, it is quite natural, that when the lexicon is small, most words will be encountered equally in different authors. I have pointed out, that those few words that had been recorded by Arnold von Harff in the fifteenth century, are widely consistent with those few words recorded by Evlija Çelebi in the seventeenth century, though they were two different centuries and two completely different authors. Approximately 4500 words of Hahn's lexicon are also in Kristoforidhi's.